



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Neneve 15.2 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Kërkesën e N.Q Termokos për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Licencave të N.Q Termokos, të datës 12.02.2009, **në seancën e mbajtur më 01 prill 2009 nxori këtë:**

## VENDIM

I. **I lejohet** N.Q Termokos derogimi në zbatimin e dispozitave të neneve të:

- Licencës për Gjenerim të Ngrohjes Qendrore;
- Licencës për Shpërndarje të Ngrohjes Qendrore; dhe
- Licencës për Furnizim Publik me Ngrohje Qendrore, si në shtojcën e këtij vendimi.

1. Të gjitha dispozitat tjera të licencave të N.Q Termokos mbesin në fuqi.
2. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
3. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në Gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e lëshimit ose data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit të tij ose datën e publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Bashkëngjitur në këtë vendim janë Nenet e deroguara.

Bordi i ZRRE-së

---

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

---

Theranda Beqiri, Anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar

---

Përparim Kabashi, Anëtar

---

Blerim Koci, Anëtar



Netet e deroguara (shtyje afati) të Licencave të N.Q Termokos

Licenca e Gjenerimit të N.Q Termokos					
Nr.	Neni	Kërkesa e I për Derogim	Kërkesa II për derogim	Deroguar nga ZRRE deri me	Koment nga ZRRE
1	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset gjeneruese të energjisë termale	deri me 31 dhjetor 2008	deri me 01 shtator 2009	deri me 01 shtator 2009	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 01.09.2009
2	Neni 5.1 Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Matës, dhe Rregullën mbi Kushtet e Përgjithshme të furnizimit me energji	deri me 31 dhjetor 2008	deri me 01 qershor 2009	deri me 01 qershor 2009	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 01.06.2009
3	Mjedisi	deri me 31 dhjetor 2008	deri me 31 dhjetor 2009	deri me 31 dhjetor 2009	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2009
Licenca për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së N.Q Termokos					
Nr.	Neni	Kërkesa e I për Derogim	Kërkesa II për derogim	Deroguar nga ZRRE deri me	Koment nga ZRRE
1	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Shpërndarjes	deri me 31 dhjetor 2008	deri me 01 shtator 2009	deri me 01 shtator 2009	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 01.09.2009
2	Neni 4.1 Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Matës, dhe Rregullën mbi Kushtet e Përgjithshme të furnizimit me energji	deri me 31 dhjetor 2008	deri me 01 qershor 2009	deri me 01 qershor 2009	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 01.06.2009
3	Neni 6.8 Deklarata (çmimore) mbi tarifat për kyçe në sistemin e shpërndarjes	deri me 30 shtator 2008	deri me 01 qershor 2009	deri me 01 qershor 2009	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 01.06.2009
4	Neni 7.4 Qasja dhe shfrytëzimi i rrjetit të shpërndarjes së ngrohjes	deri me 31 dhjetor 2008	deri me 01 qershor 2009	deri me 01 qershor 2009	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 01.06.2009
5	Neni 12.1-Standardet e sigurisë së sistemit të Shpërndarjes dhe planifikimit	deri me 31 dhjetor 2008	deri me 01 qershor 2009	deri me 01 qershor 2009	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 01.06.2009
6	Neni 13.2-Standardet e përmbushjes së Biznesit të operimit të sistemit të Shpërndarjes	deri me 31 dhjetor 2008	deri me 01 qershor 2009	deri me 01 qershor 2009	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 01.06.2009
Licenca për Furnizim Publik me Ngrohje Qendrore e N.Q Termokos					
Nr.	Neni	Kërkesa e I për Derogim	Kërkesa II për derogim	Deroguar nga ZRRE deri me	Koment nga ZRRE
1	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit	deri me 31 dhjetor 2008	deri me 01 shtator 2009	deri me 01 shtator 2009	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 01.09.2009
2	Neni 5.1 Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Matës, dhe Rregullën mbi Kushtet e Përgjithshme të furnizimit me energji	deri me 31 dhjetor 2008	deri me 01 qershor 2009	deri me 01 qershor 2009	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 01.06.2009